



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
NJËSIA E PROKURIMIT

Nr. _____ Prot.

Data _____. _____. 2024

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-PUNË

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROKURIMIT: Rikonstruksion i rrugës "Siqeca (Kashtë e bardhë)", fshati Kurjan, 750 ml, (asfaltobeton 4 ml , bankin-2x0.5 m).

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Punime gërrmuese-45112400-9, Punime ndërtimi për rrugë-45233120-6,

VLERA E FONDIT LIMIT: 5 890 476.25(pesë milion e tetëqindë nëntëdhjetë mijë e katërqindë e shtatëdhjetë e gjashtë pikë njëzetë e pesë)lekë pa tvsh,

Argumentimi i fondit limit: Komisioni i llogaritjes fondit limit dhe specifikimeve teknike për llogaritjen e fondit limit ka marr në dorëzim project-preventivin dhe dokumentacionin teknik përkatës të hartuar nga Shoqëria "A.SH.Engineering" shpk i cili rezulton se i është referuar nenit 76 të pikës (a) të VKM-së me nr.285, datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave "Për rregullat e prokurimit publik" i ndryshuar, që përcakton "çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj)", Shoqëria "A.SH.Engineering" shpk për llogaritjen e cmime është mbështetur ne manualin teknik te çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizave teknike të tyre nr.625 datë 15.07.2015,(ndryshuar me VKM-në nr.631,datë 26.10.2018 ,me qëllim që vlera limit e kontratës, të jetë një vlerë e matshme dhe njëkohësisht e të krijojë mundësinë e pjesëmarrjes së sa më shumë operatorëve ekonomikë.

Arsyeja e përdorimit të procedurës së prokurimit "E hapur e thjeshtuar" është sepse fondi limit është nën kufirin e ulët monetar, bazuar në ligjin nr.162 datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" i ndryshuar me ligjin nr.16/2024 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.162/2020 "Per prokurimin publik" nenin 49 si dhe në VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" I ndryshuar nenin 11, pika 1, gërma b dhe neni 55,74,77 .

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Roskovec ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

b. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme për sigurimin e ofertës mbështetet në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik i ndryshuar me ligjin nr.16/2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.162/2020 “Per prokurimin publik”;;”, Neni 83, pika 1 si dhe në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni II, Neni 30, pika 1.

Kërkesa për Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit bazohet në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar me ligjin nr.16/2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.162/2020 “Per prokurimin publik”, Neni 82 si dhe në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni II, Neni 26.

Këto kriterë janë vendosur për të vertetuar pjesëmarrjen ose jo të operatorit ekonomik në tendera, duke paraqitur oferte.Gjithashtu këto kriterë janë vendosur edhe për të vërtetuar deklaratimet dhe dokumentat e paraqitura nga operatorët ekonomik, duke kaluar tërësisht përgjegjesinë administrative ose penale gjithashtu barrën e proves tek operatorët ekonomik për dokumentat e paraqitura.

c. Formulari i Ofertës ,sipas Shtojcës 1

d.Lista e çmimeve të artikujve sipas zërave të preventivi sipas shtojcës 2;

Shenim:Dokumentat e kërkuara më sipër në pikën d dhe c do të paraqitën përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik,i ndryshuar”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 7, gërma “ç” (sipas Shtojcës 1 dhe 2 te DST).

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1.Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

Plotësimi i kapaciteteve ligjore nga operatorët ekonomikë dhe vërtetimi se ata kanë zotësi juridike për të lidhur kontrata prokurimi, bëhet me anë të paraqitjes prej tyre të deklaratës mbi përmbushjen e kriterëve të përgjithshme, sipas shtojcës 7 dhe 8.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 14, pika 2, dhe 77, pika 1/a dhe 2, të LPP i ndryshuar me ligjin nr.16/2024 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.162/2020 "Per prokurimin publik"; nenin 39, pika 6/b, dhe nenin 88, *Pika 4 të* të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar.

Ky kriter vendoset për të vërtetuar që operatori ekonomik pjesmarrës ka eksperiencën e duhur dhe kapacitetin potencial ekonomik.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori për vitet financiare 2021, 2022 dhe 2023, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës e përkatësisht: 2 300 000 lekë pa tvsh.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Duke patur në konsideratë vlerën e objektit të prokurimit: "**Rikonstrukcion i rrugës "Siqeca (Kashtë e bardhë)", fshati Kurjan, 750 ml, (asfaltobeton 4 ml , bankin-2x0.5 m).**" pika 3 e nenit 77 të LPP", i ndryshuar me ligjin nr.16/2024 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.162/2020 "Per prokurimin publik"; dhe sipas parashikimeve në nenin 43, pika 1 dhe 2/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, ku parashikohet se: "Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar.", si dhe mbi bazën e nenit 29, të ligjit nr. 8438, dt. 28.12.1998 "Për Tatimin mbi të Ardhurat", i ndryshuar, ku përcaktohet se: "Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës.", si pika 1 dhe 2/c, në zbatim të nenit 29 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", si dhe nenit neni 41, gërma "c" të ligjit nr.10091 datë

5.3.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar" i ndryshuar.

2.2.2. 1-Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm Operatori ekonomik duhet të paraqesë kopje të certifikuara të bilanceve të viteve 2022, 2023 të paraqitur në autoritetet përkatëse dhe të konfirmuara nga ky autoritet, me nenshkrim dhe vule. *Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit*". Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e Ligjit Nr. 16/2024 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik", si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në përputhje me ligjin nr. 10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, Kreu V, neni 41, pika c

2.2.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një dokument që vërteton se ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore për të gjitha vendet ku operatori ushtron aktivitet për vitin 2023 (Sipas QKB) sipas përcaktimeve në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore për vitin 2023.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e Ligjit Nr. 16/2024 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik", si dhe nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore" i ndryshuar, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 "Per procedurat tatimore" i ndryshuar, neni 4, pika 2 d). Referuar sa mësipër, njësia e prokurimit gjykon se kriteri i vendosur nga autoriteti kontraktor lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të vertetimit të shlyerjes së detyrimeve vendore është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për "Sistemin e Taksave Vendore" i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për tju nënshtruar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Përvojë të suksesshme në realizimin e të paktën:

a) Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 30% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pese viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës e përkatësisht: 1 700 000 lekë pa tvsh.

Ose

b) Punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pese viteve të fundit, të jetë jo më e vogël se vlera limit e kontratës që prokurohet e përkatësisht: 5 800 000 lekë pa tvsh.

Plotësimi i njërës prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

**Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomike, Pika 2.3.1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 2.3.1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.*

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Kontratë Sipërmarrje
- Situacionin përfundimtar
- Akt i kolaudimit
- Formular vleresimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9;

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Kontrate Sipërmarrje;
- Situacion/faturë tatimore;
- Akt i kolaudimit
- Formular vleresimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9;

Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën e bashkimit të operatorëve të deklaruara në fazën e tenderimit.

Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën baze ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor, si dhe miratimin nga ana e Autoritetit Kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar me ligjin nr.16/2024 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.162/2020 "Për prokurimin publik"; dhe në nenin 55, pika 4, të VKM nr.

285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” , i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 30% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës ose punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se vlera limit e kontratës që prokurohet. .

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë: Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garantojnë autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së punëve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1, 3 e VKM 285/2021, parashikon se “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve. AK argumenton se Puna e ngjashme është kërkesë, e cila shërben për të vlerësuar përvojën e duhur të Ofertuesve. Vlerësimi i përvojës realizohet duke paraqitur dokumentat e kërkuara sipas pikave (pika a(1,2,3,4,) dhe b(1,2,3,4), të cilat vërtetojnë eksperiencën në realizimin e punëve publike/private të ngjashme, si dhe janë një garanci më shumë për Autoritetin Kontraktor me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, sipas formatit të miratuar me *Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 42 date 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhenies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”* e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

Nr.	Licenca	Kategoria e kryerjes së punimeve
1	NP-4A	Rrugë autostrada, ura, mbikalime, hekurudha, linja tramvaji, metro, hekurudhë me kavo dhe pista aeroportuale
2	NP-1A	Punime gërmimi në tokë;

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar me ligjin nr.16/2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.162/2020 “Per prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, ku parashikohet se: ”Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga

organet kompetente shtetërore.”, si dhe në klasifikimin e niveleve (gërmave) për punimet sipas natyrave respektive, të parashikuara në VKM Nr.42 date 16.01.2008, “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar,

Te dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjit Nr. 8402 datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, neni 8 përcakton "Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standartet kombëtare ose europiane. Referuar kategorive të kërkuara, AK argumenton teknikisht se kjo kërkesë është vendosur sipas zërave të preventivit të punimeve. Kjo kërkesë është vendosur nga Autoriteti Kontraktor me qëllim shqyrtimin e kualifikimit profesional të Ofertuesve në kuadër të veprimtarisë tregtare objekt prokurimi.

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

Kategoria e kërkuar	Përshkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive	Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
N.P. 4 Rrugë autostrada, mbikalime, hekurudha, linja tramvaji, metro, hekurudhë	Përfshin në mënyrë të thjeshtuar rrugët, pavarësisht nga shkalla e tyre e rëndësisë, autostradat, superstradat përfshirë ndërhyrjet në pika të veçanta, tunelet, devijimet nën nivele dhe në lartësi, parkimet, punime të mureve mbajtëse, hekurudha, metro, hekurudhë me	Shtrese çakelli mbeturine kave t=15cm, përhapur e ngjeshur me makinë	Niveli me maksimum 5 balke	57929.93 lekë pa tvsh
		Shtrese asfaltbetoni me granil guri kave, 5cm, me makinë		

me kavo dhe pista aeroportuale.	kavo, tranvai, pista aeroportuale, sheshet e helikopterëve, sheshet të realizuara me materiale të veçanta, natyrale dhe artificiale, urat, si dhe komplekse karakteristikash teknike, në hekur, betonarme të thjeshtë dhe të paranderur, parafabrikat ose të prodhuar në objekt			
NP.1 Puni me germimi në tokë;	Konsiderohen gërmimet, sistemimet dhe ndryshimet në volum të tokës, të realizuara me çfarëdo lloj mjete, pavarësisht nga natyra e terrenit që do të gërmohet ose sistemohet, vegjetale, argjilore, ranore, zhavorrishte ose shkëmbore	Gërmim dhe në rrugë + kanal anësor	Niveli A	98182leke pa tv

Klasifikimi sipas niveleve për çdo kategori punimesh zbatimi i referohet Vendimit të Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi” *i ndryshuar*

2.3.3. a. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor, drejtues teknik** në licencën e shoqërisë, jo më pak, si më poshtë:

- Inxhinier Ndërtimi -1 (një)

Për të cilin duhet të paraqiten:

- Kontratë punë e vlefshme

- Diploma
- CV
- Licence

Drejtuksi teknik duhet të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë **për muajin e fundit**.

** Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, operatorët ekonomik duhet të deklarojnë për punonjesin e kërkuar si me siper, emer/mbiemer, numrin dhe datën e certifikatës, si dhe institucionin që ka leshuar këtë dokument.*

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DST. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten referuar përcaktimeve të nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar , përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor

Argumentimi: Së pari, kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 16/2024 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik", Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma "c".

*Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Drejtuesi teknik është përgjegjës për ndërtimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës. Bazuar në parashikimet e mësipërme të legjislacionit për prokurimin publik, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij **drejtues teknik** të cilët kanë një rol të rëndësishëm në mbarëvajtjen e punimeve pasi ata janë përgjegjës për zbatimin e objektit sipas projektit dhe në përputhje me kushtet teknike të zbatimit të tij.*

Kriteri për stafin teknik kryesor, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Stafin i inxhinierëve, është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

Personeli i mësipërm kërkohet në bazë të vlerësimit të preventivit dhe të grafikut të punimeve.

- **Inxhinieri i Ndërtimit** kërkohet për zbatimin e saktë të punimeve strukturore të objektit që do të ndërtohet sipas parashikimeve në projektin.

2.3.3. b. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe **stafin mbështetës** (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), si më poshtë:

- 1 (një) Inxhinier Ndertimi

Për Inxhinier Ndertimi duhet të paraqiten:

- Kontratë punë e vlefshme
- Diploma
- CV

Inxhinier Ndertimi të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë **minimalisht për muajin e fundit.**

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DST. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën referuar përcaktimeve të nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar , përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

***Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të Nenit të 77, Ligjit Nr. 16/2024 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik" dhe Nenit 39, pika 6/c) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për stafin mbështetës lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.*

2.3.3. c. Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të dëshmojnë se kanë të punësuar në stafin e shoqërisë punonjës të kualifikuar, të pajisur me Dëshmi të Aftësisë Profesionale (DAP), lëshuar nga D.P.SH.T.RR. **minimalisht** si më poshtë:

- Manovratore 2 (dy)
- Shofer 1 (një)
- 2 (dy)Puntor të thjesht

Për këtë operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

- Kontratat e punës të vlefshme;
- Dokument (dëshmi kualifikimi profesional), që të vërtetojë kualifikimin profesional të kërkuar, referuar rregullores "Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e Dëshmisë së Aftësisë Profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtim dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të tyre", miratuar me urdhërin nr. 200, datë 16.5.2019, të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjitikës.
- Keta punonjes të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë **minimalisht për muajin e fundit.**
- (Në rastin kur punonjësit Manovrato/Shofer janë të kontraktuar me kontratë pune (respektivisht për mjetet e marra me qera), nuk kërkohet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë).

** Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, operatorët ekonomik duhet të deklarojnë për punonjësit e kërkuar si me sipër, emer/mbiemer, numrin dhe daten e deshmise së aftësisë profesionale.*

**(Në rastet kur mjetet/makineritë disponohen me qera, këta punonjës mund të jenë të kontraktuar).*

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën referuar përcaktimeve të nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar , përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4 i ndryshuar me ligjin nr.16/2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.162/2020 “Per prokurimin publik”; në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”i ndryshuar , Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c” i ndryshuar.

Njësia e Prokurimit duke marrë në konsideratë natyrën e punimeve; makineritë që do të kërkohen për realizimin e punimeve (Shtojca 8) si dhe Preventivin e Punimeve shtron nevojën që Ofertuesit të kenë të punësuar Manovrator me qëllim realizimin e kontratës me sukses. Numri i këtyre punonjësve është përcaktuar duke marrë në konsideratë volumet e punimeve për secilin zë pune mbështetur kjo në VKM Nr. 629 datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizat teknike të tyre”. Gjithashtu me qëllim nxitjen e garës është përcaktuar rasti përjashtimor ku për Manovratorët që janë të kontraktuar me kontratë pune (respektivisht për mjetet e marra me qera), nuk kërkohet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë.

Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

2.3.4. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej minimalisht **6(gjashtë) punonjës persona te pasqyruar në listëpagesën e muajit e fundit.** Për përmbushjen e këtij kushti operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet Shoqërore ose Administrata Tatimore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, ku të specifikohet numri i punonjësve per muajin e fundit.
- Listëpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi per muajin e fundit.

(Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomike kjo pik. duhet te plotesohen nga secili anëtar i bashkimit, në përputhje me natyrën e punimeve dhe përqindjen e pjesëmarrjes në punë, të përcaktuara në akt marrëveshje).

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën referuar përcaktimeve të nenit 26, pika 6,

të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar , përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentim: *Autoriteti Kontraktor këtë kriter e ka bazuar në nenin 77, pika 4 të Ligjit nr.162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar me ligjin nr.16/2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.162/2020 “Per prokurimin publik” në të cilin thuhet: “Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës”.*

Numri i punonjësve është përcaktuar bazuar në afatin, orët e punës, që duhen për të përmbushur zbatimin e kontratës. Numri i punonjësve, tregon besueshmëri për autoritetin. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë çdo dëshmi me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve dhe përvojën e tyre, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, përpiqet të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës, po ashtu është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve. Vendosja e kriterit për një punësim te paktën 6 është në përputhje me volumin e punës, natyrën, ku do të kryhen punimet. Po t’i referohemi projektit, preventivit, relacionit, matjeve përkatëse që ka bërë projektuesi është plotësisht i justifikuar numri i punonjësve. Kriteri për kualifikim është vendosur që t’i shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Gjithashtu për të vërtetuar zotërimin e fuqisë punëtore si dhe stabilitetin e saj është kërkuar edhe vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore si dhe listpagesat e punonjësve mbështetur edhe në Kreun V, Seksioni III, Neni 39, pika 8 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, sipas së cilës: “Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”.

2.3.5 *Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:*

Nr	Lloji i makinerive	Njësia	Sasia	Statusi
1	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 15 ton	Copë	1	Në pronësi ose me qira
2	Rul vibrues gom-hekur me kapacitet 10 ton	Copë	1	Në pronësi ose me qira
3	Autobot uji	Copë	1	Në pronësi ose me qira
4	Fadrom me goma	Copë	1	Në pronësi ose me qira

5	Grejder	Copë	1	Në pronësi ose me qira
----------	----------------	-------------	----------	-------------------------------

- a) Për mjetet me rrota që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (te vlefshme).
- b) Për mjetet e siguruara me qera, dokumenti që verteton regjistrimin e tij (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit te vlefshme), duhet të shoqerohet me kontraten perkatese te qerase e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates objekt i ketij prokurimi. Në rastin e mjeteve të tjera duhet të jene aktet e zhdoganimit ose faturat tatimore te blerjes.
- c) Për mjetet dhe pajisjet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre, si kontrata e blerjes ose fatura e zhdoganimit ose fatura tatimore perkatese.
- d) Autoriteti Kontraktor gezon te drejten te verifikojë dhe kontrollojë disponueshmerine e ketyre mjeteve si gjate vleresimit te ofertave ashtu edhe gjate zbatimit te kontrates.
- e) Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit dhe Makineritë e mësipërme nuk duhet të jenë të angazhuara në kontrata të tjera apo të deklaruara ne procedura te shpallura fitues.

(Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomike pikat e kriterit 2.3.5. duhet te plotesohen nga secili anëtar i bashkimit, në përputhje me natyrën e punimeve dhe përqindjen e pjesëmarrjes në punë, të përcaktuara në akt marrëveshje).

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DST. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën referuar përcaktimeve të nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar , përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi : *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të Ligjit Nr. 16/2024 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik" dhe nenit 39, pika 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", të ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Mjetet dhe pajisjet e kërkuara janë vendosur në proporcion me zërat dhe volumet e punimeve dhe afatin e përllëgaritur për realizimin e kontratës objekt prokurimi.*

Numri dhe lloji i makinerive, paisjeve në pronësi / qira janë vlerësuar si të nevojshme në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke i'u referuar punimeve sipas standardeve, grafikut, kohëzgjatjes së punimeve dhe specifikimeve teknike të projekt zbatimit. Për të zbatuar kontratën, operatorët ekonomikë duhet të përmbushin kapacitetet teknike të pajisjeve dhe asetëve të tjera fizike, për këtë janë përcaktuar edhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin ofertuesit. Nëpërmjet kapaciteteve teknike operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë aftësinë dhe kualifikimet e

nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative. Pajisjet dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës si dëshmi për mjetet dhe pajisjet sipas specifikave.

2.3.6. Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të vërtetojë se e zhvillon aktivitetin e tij në fushën objekt prokurimi në përputhje me standardet e menaxhimit të cilësisë. Për këtë duhet të paraqesin certifikatën e mëposhtme:

- **Çertifikatë ISO 9001:2015 ose ekuivalente mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë”** lëshuar nga institucionet zyrtare të akredituara për këtë qëllim;

(Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomike kjo pikë duhet të plotësohet nga secili anëtar i bashkimit, në përputhje me natyrën e punimeve dhe përqindjen e pjesëmarrjes në punë, të përcaktuara në akt marrëveshje).

Argumentim: Kërkesat e cilësisë të përcaktuara sipas pikës 14 gërma “a”- “e” janë vendosur në mbështetje të të Ligjit Nr. 16/2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 79, pika 1 ku citohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatën të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe në zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” indryshuar, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatën të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.

AK gjykon se kërkesa për pajisjen e Ofertuesve me Çertifikatat e kërkuara është brenda kuadrit të parashikuar nga legjislacioni për prokurimin publik. Çertifikatat e kërkuara janë në përputhje me objektin e kontratës dhe respektojnë natyrën e punimeve. ISO 9001:2015 është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit të cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërrmarjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërrmarje duhet t’i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërrmarjes në standardet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001:2015 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të paraqesë grafikun e punimeve të detajuar sipas zërave të preventivit (Bashkëlidhur DST) të shprehur në afatin kohor të përcaktuar në dokumentat e tenderit për 3(tre) muaj kalendarike.

Argumentimi: Kjo kërkesë është vendosur në mbështetje të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 3. **Ky kriter vendoset me qëllim që të përcaktohet në mënyrë të qartë shpërndarja e fuqisë puntore dhe e mjeteve me anë të një grafiku punimesh.**

2.3.8Referuar pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet : *“Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”*, si dhe përcaktimet e pikës 6 të këtij neni ku parashikohet: Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

Argumentimi :Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 26, pika 1e VKM-së, nr.285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar .

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Argumentimi i specifikimeve teknike

Punimet objekt prokurimi, të cilat shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, bazohen në parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të Ligjit Nr. 16/2024 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

SPECIFIKIMET TEKNIKE TË KËTIJ OBJEKTI PROKURIMI JANË PËRCAKTUAR NGA PROJEKTUESI, SIPAS MATERIALIT BASHKËLIDHUR NE SPE.

U ra dakort nga antaret e Njesisë së Prokurimit të ngritur me urdher të titullarit të autoritetit kontraktor, **nr.53, datë.28.05.2024**, për këto kërkesa për kualifikim pasi kërkesat e mësipërme janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës që është **:Rikonstruksion i rrugës "Siqeca (Kashtë e bardhë)", fshati Kurjan, 750 ml, (asfaltobeton 4 ml , bankin-2x0.5 m)..**, me fond limit prej: **5 890 476.25(pesë milion e tetëqindë nëntëdhjetë mijë e katërqindë e shtatëdhjetë e gjashtë pikë njëzetë e pesë)lekë pa tvsh,, lloji i procedures: E hapur e thjeshtuar.**

Ato do të shërbejnë për njohjen e plotë të gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës .

Kërkesat e veçanta të kualifikimit të mësipërme përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me LPP dhe VKM nr.285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Kriteret e hartuara janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Për secilin kriter janë përcaktuar dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e atyre kriterëve.

Preventivi I hartuara nga “A.SH.Engineering” shpk si mëposhtë për objektin”:

Rikonstruksion i rrugës "Siqeca (Kashtë e bardhë)", fshati Kurjan, 750 ml, (asfaltobeton 4 ml , bankin-2x0.5 m).

PREVENTIVAT E PUNIMEVE

Objekti : Rikonstruksion i rruges "Siqeca (Kashta e bardhe)", fshati Kurjan, 750ml, (asfaltobeton-4m, Bankine-2x0.5m)

Nr.	Nr. An.	Emërtimi i punimeve	Njësia	Sasia
1. Punime në rrugë				
1	3.87/b	Germim dheu ne rruge + kanal anesor	m ³	315
2	3.210	Shtrese çakelli mbeturine kave t=15cm, perhapur e ngjeshur me makineri+bankine t=15 cm	m ³	564
3	3.226/2	Shtrese asfaltobetoni me granil guri kave, 5cm, me makineri	m ²	3035
SHUMA 1				
		TVSH 20%		
		TOTALI		

Dokumentacioni pasi u firmos nga të tre anëtarët e Njesisë së Prokurimit, pasi u përpilua edhe formulari përmbledhës i njoftimit të kontratës, do të paraqitet titullarit të autoritetit kontraktor për t’u firmosur dhe u ra dakort që të hidhen në formatin e sistemit elektronik nga personi përgjegjës i prokurimeve anëtar i NJ.P, për shpallje dhe botim nga APP.

NJËSIA E PROKURIMIT

